



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 67.
Prishtinë, më 28.05.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Petar Miletic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Goran Marinkovic, Elmi Reçica dhe Glauk Konjufca.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-së, Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues nga IND- ja Xhemajl Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković**, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.05.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit, me report dhe amandamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik, me report dhe amandamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-185 për tarifat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me report dhe amandamente të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa;
6. Të ndryshme.

Jasmina Živković – fillimisht e njoftoi komisionin se me propozim të Grupit Parlamentar SLS, në mbledhjen Plenare të datës 23 maj 2013, është marr vendim se unë - Jasmina Živković të emërtohem kryetare e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në vend të deputetit Goran Marinković.

Jasmina Živković – shprehuhu qëndrimin e saj se si kryetare e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, se të gjitha detyrimet dhe obligimet do ti marr me përgjegjësi dhe seriozitet ku njëherit kërkoi nga anëtarët e komisionit të ketë bashkëpunim të ndërsjellë.

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 21.05.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit, me report dhe amandamente të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Kryesuesi – e njoftoi komisionin se ka vërejtje në Projektligjit për produktet e ndërtimit, nga se Raporti me amandamente i komisionit funksional paraqet shkelje dhe cenim të të drejtave dhe interesave të komuniteteve.

Petar Miletić- tha se ndjehet i privilegjuar që Znj Jasmina Živković është zgjedhur kryetare e komisionit dhe shtoi se çështjet dhe detyrat të cilat na presin do të kryhen me kohë në të ardhmen. Sa i përket **Projektligjit për produktet e ndërtimit**, ai tha se propozimi i Qeverisë është i mirë nga se ka respektuar nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër shprehu shqetësimin e tij se disa nga amendamentet e komisionit funksional prekin dhe cenojnë të drejtat e komuniteteve.

Propozoi që komisioni funksional ti ndryshoj amendamentet të cilat prekin të drejtat e komuniteteve dhe shkelin Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Myfera Sink –tha se Projektligji për produktet ndërtimore ka ardhur i kompletuar nga Qeveria mirëpo ishte e mendimit që propozim amendamentet e komisionit funksional janë kudër Kushtetues dhe se shkellet Ligji për Përdorimin e Gjuhëve.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me 7 vota kundër dhe 2 abstenim nxori këtë:

Përfundim

- 1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e shqyrtoi P/ligjin nr. 04-L-181 për produktet e ndërtimit me Raportin dhe amendamentet e propozuara nga komisioni juaj, si komision raportues, dhe konstatoi se amendamentet: 11,17,20,22,23,33 dhe 34 i cenojnë dhe i rrezikojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve, sepse janë në kundërshtim me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve.*

2. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe me qëllim të sigurimit që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të trajtohen në mënyrë adekuate në ligj, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim rekomandon që komisioni funksional t'i shqyrtojë vërejtjet e dhëna në amendamentet kontestuese dhe pastaj të na informojë për qëndrimin e komisionit, në pajtim me detyrimet koordinuese të punës në mes të komisioneve kuvendore.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik, me report dhe amandamente të Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 04/L-187 për treguesit gjeografik dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, me report dhe amandamente të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin nr.04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme;

Myefra Sinik – tha se për arsye të angazhimeve parlamentare nuk ka marr pjesë në takimin e komisionit me datën 26.04.2013 andaj ishte e interesuar të informohet në lidhje me vendosmërinë e komisionit tanë në Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga Shteti, në mospërkrahje të amendamenteve 6, 9, 10, 16, 17, 18 dhe 22, nga ana buxhetore.

Petar Miletic- lidhur me këtë çështje theksoi se komisioni është dekoduar që nuk është kompetent të ndërhyjë nga ana e implikimeve buxhetore andaj jemi distancuar pasi i njëjti nuk shkel të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Mursel Halili - përgëzoj deputeten Jasmina Zivkovic për pozitën e re duke i uruar suksese dhe bashkëpunim të mirë.

Sa i përket çështjes së ngritur nga zen, Myfera, tha se ka qen kundër votimit të atyre amendamenteve dhe se ka abstenuar për votimin e të njëjtave.

Pas diskutimeve të shumta znj Myfera morri përgjigje se Komisioni ka miratuar raportin me amandamente të komisionit funksional përveç amendamenteve 6, 9, 10, 16, 17, 18 dhe 22, të cilat paraqesin implikime buxhetore.

Petar Miletic – në fund të takimit ngiti çështjen e marrjes së iniciativës për realizimin e vizitave jashtë shtetit ku mund të shfrytëzohen edhe mjetet buxhetore të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković